REZOLUTË

ME RASTIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT

Kuvendi i Shqipërisë përshëndet nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe vlerëson se ai përbën një moment historik në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje shënon kurorëzimin e përpjekjeve disavjeçare në afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Europian.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nis një fazë të re në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për përgatitjen e vendit për anëtarësim të plotë në BE, gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me BE-në dhe në zbatim e respekt të plotë të kritereve të Kopenhagenit dhe konkluzioneve të Samitit të Selanikut.

Kuvendi i Shqipërisë është i ndërgjegjshëm se zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është vendimtar dhe themelor për përparimin e mëtejshëm dhe përshpejtimin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Kuvendi është i ndërgjegjshëm se në rrugën e reformave drejt integrimit të mëtejshëm nuk ka rrugë të shkurtra.

Kuvendi shpreh gatishmërinë dhe angazhimin e tij të plotë për të mbështetur përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëdhënie e re institucionale me Bashkimin Europian, veçanërisht në drejtim të forcimit të shtetit ligjor, të të drejtave të njeriut, të konsolidimit të ekonomisë së tregut, të luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar, në ruajtjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative me realizimin e të gjitha reformave, të cilat sjellin rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Një vëmendje dhe angazhim të veçantë Kuvendi i Shqipërisë do të tregojë për realizimin e reformës zgjedhore, me qëllim realizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe përfaqësimin e drejtë të vullnetit të qytetarëve. Nga ana tjetër, Kuvendi i kërkon BE-së dhe vendeve anëtare që, pas nënshkrimit dhe ratifikimit nga ana e Republikës së Shqipërisë të Marrëveshjes së Ripranimit dhe në përputhje me konkluzionet e Samitit të Selanikut, të vlerësojë masat për një liberalizim në rritje të lëvizjes së personave, si një aspiratë themelore e popullit shqiptar dhe si një tipar konceptual i integrimit europian.

Kuvendi i Shqipërisë shpreh vullnetin e tij për të mbështetur intensifikimin e bashkëpunimit me strukturat e Bashkimit Europian, në veçanti me vendet anëtare, Komisionin Europian dhe Parlamentin Europian. Kuvendi shpreh angazhimin e tij për një proces të shpejtë të ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nga parlamentet e vendeve anëtare dhe për dhënien e pëlqimit nga Parlamenti Europian. Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Shqipërisë hartimin e një axhende konkrete për etapat e mëtejshme në procesin e integrimit europian, përfshirë këtu edhe objektivat kohorë dhe cilësorë për marrjen e statusit të kandidatit.

Kuvendi i Shqipërisë shpreh dëshirën e tij që nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të shërbejë si një nxitje e motivim i fuqishëm për vendet e rajonit në rrugën e tyre të integrimit europian dhe të shënojë në cilësi të re në marrëdhëniet midis vendeve tona. Kuvendi i Shqipërisë do të vijojë të mbështesë me vendosmëri politikën konstruktive të Republikës së Shqipërisë në rajon, duke synuar një rajon më stabël, më të integruar e me mirëqenie në rritje.

Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Shqipërisë t'ia përcjellë këtë rezolutë vendeve anëtare të BE-së, Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian.

Tiranë, më 8.6.2006